




Pranuar / Dërguar Prilazhen / Prilazhen Received / Delivered	01-04-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Di / Prot Di / Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSHCK	1790/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.146/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.146/2022 të datës 21.02.2022 të parashtruar nga ankuesi me banim në kundër Vërejtjes me shkrim të datës 24.01.2022 të Kryesuesit të Njesisë për përgatitjen e shitjeve, shqyrtimit ligjor dhe tenderimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 01.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.146/2022 e datës 21.02.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vërejtja e datës 24.01.2022 e Kryesuesit të Njesisë për përgatitjen e shitjeve, shqyrtimit ligjor dhe tenderimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
- III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke nxjerrë vendim për largimin e vërejtjes me shkrim të datës 24.01.2022 nga dosja e ankuesit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesit i punësuar në pozitën “Zyrtar Ligjor për Shqyrtimin e Dokumenteve të të Shitjes”, sipas akt emërimit me numër të referencës 30/DSH 7 të datës 27.05.2019, pranë Njesisë për përgatitjen e shitjes, shqyrtimit ligjor dhe tenderimit në Departamentin e Shitjes së Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me datë 24.01.2022, Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore vërejtje me shkrim.

Ankuesi i pakënaqur me vërejtjen me shkrim të datës 24.01.2022, e shqiptuar nga ana e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë si Kryesues i Njesisë për përgatitjen e shitjeve, shqyrtimit ligjor dhe tenderimit pranë Departamentit të shitjes në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me datë 21.02.2022, ka parashtruar ankesën me Nr.Prot:898/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se vërejtja e shqiptuar është në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe Rregulloren Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, i njëjti pretendon se që nga viti 2019 vetëm 3 ditë të pushimit mjekësor i ka shfrytëzuar dhe se për ditët e munguara në punë lidhur me datat 20.01.2022 dhe 21.01.2022 ka qenë në pushim mjekësor, kërkon që vërejtja e shqiptuar ti anulohet, si dhe deklaron se pjesa lidhur me këshillën juridike tek vërejtja e shqiptuar është në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, me datën 24.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Agjencia Kosovare e Privatizimit. Agjencia Kosovare e Privatizimit me datën 08.03.2022 përmes Divizionit për Burime Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 21.02.2022 me Nr.Prot:898/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raportin e ekzaminimit biologjik lidhur me testin për covid të datës 25.01.2022 nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës; Raportin e datës 21.01.2022 mbi testin rapid për ankuesin nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare-Skenderaj; E-mailin zyrtar të datës 25.01.2022 nga ankuesi; Sms i datës 20.01.2022 nga telefonia mobile e ankuesit; Formularin e datës 24.01.2022 mbi shqiptimin e vërejtjes me shkrim për ankuesin; Formularin e datës 24.01.2022 mbi shqiptimin e vërejtjes me shkrim për ankuesin; Raportin mjekësor të datës 20.01.2022 nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Skenderaj; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 24.02.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 08.03.2022 nga Agjencia Kosovare e Privatizimit; Akt emërimit e ankuesit me numër të referencës 30/DSH 7 të datës 27.05.2019 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; E-mailin zyrtar të datës 24.01.2022 nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit për ankuesin; Raportin e prezencës në punë për periudhën 01.01.2022-31.01.2022 për ankuesin të datës 04.03.2022; E-mailin zyrtar të datës 10.02.2022 nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit për ankuesin; E-mailin zyrtar të datës 10.02.2022 nga ankuesi për Udhëheqësin e drejtpërdrejtë të tij.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka vërtetuar se ankesa e ankuesit *është e bazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar provat e lëndës lidhur me shqiptimin e Vërejtjes me shkrim të datës 24.11.2022, e shqiptuar nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, ka konstatuar se ankuesi me datën 20.01.2022 ka munguar në punë, me arsyetimin se vëllai i tij me datën 19.01.2022 ka rezultuar pozitiv me virusin SARS COV, fakt ky i cili vërtetohet edhe në bazë të raportit të ekzaminimit mikrobiologjik të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës të datës 25.01.2022. Pas kësaj situatë ankuesit kanë filluar ti shfaqen simptomat e gripit ku me datën 20.01.2022 ka shkuar për kontroll pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, ku është udhëzuar që me datën 21.01.2022 të testohet lidhur me shenjat për sars cov 2, e që i njëjti po me këtë datë është testuar dhe ka rezultuar negativ siç vërtetohet edhe me faktin mbi raportin për testin rapid sars cov 2 të datës 21.01.2022. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në faktet e mësipërme, ka konstatuar se edhe pse ankuesi me rastin e mungesës në punë për datën 20.01.2022 dhe 21.01.2022 ka dërguar shenjat mjekësore tek Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar Formularin mbi Vërejtjen me shkrim të datës 24.01.2022 i shqiptuar ndaj ankuesit nga ana e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë si Kryesues i Njesisë për përgatitjen e shitjeve, shqyrtimit ligjor dhe tenderimit pranë Departamentit të shitjes në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ka konstatuar se kjo vërejtje fillimisht që i është dorëzuar ankuesit është hartuar mbi bazën e nenit 5 paragrafit 1.5 si dhe nenit 7 paragrafit 1.2 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil. Ndërlidhur me këtë fakt, Kolegji ka konstatuar se hartimi i Vërejtjes së shqiptuar mbi këtë bazë nga ana e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, është në kundërshtim dhe përbën shkelje të dispozitave në fuqi, ngase pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë të datës 09.07.2020 sipas Aktgjykimit GJK-KO203/19-AKV të Gjykatës Kushtetuese, është shfuqizuar Ligji për Shërbimin Civil Nr. 03/L-149 dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë ligj, duke përfshirë edhe Rregulloret e vjetra që kanë qenë në fuqi, andaj edhe vërejtja e tillë nuk prodhon efekt juridik për palën dhe si e tillë është në kundërshtim me dispozitat ligjore tanimë në fuqi që rregullojnë Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, po ashtu pas analizimit të Formularit të Vërejtjes me shkrim të datës 24.01.2022, i dorëzuar për herën e dytë ankuesit nga ana e Udhëheqësit të Drejtpërdrejtë të tij, ka konstatuar se kjo vërejtje është hartuar mbi bazën e nenit 47 paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, mirëpo tek pjesa e këshillës juridike citoj: *“Kundër kësaj vërejtje palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së vendimit nga Komisioni Disiplinor i AKP-së”,* udhëzimi për këshillën juridike ankuesit i është dhënë për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave. Bazuar mbi këtë konstatim, Kolegji vlerëson se Vërejtja e datës 24.01.2022 e shqiptuar për ankuesin nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i tij, nuk përmban të gjitha elementet e detyrueshme të aktit administrativ, ashtu siç kërkohet me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konkretisht me nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të këtij ligji, në të cilin përcaktohet se: *“1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.4. pjesën*

përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë” dhe si e tillë është në kundërshtim me dispozitat e tanishme, ngase me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë sipas nenit 24 paragrafit 3 kompetent për vendosjen lidhur me ankesat e nëpunësve civil është drejtpërdrejtë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili precizon saktë këtë dispozitë : “ 3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji....” .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se masa disiplinore “vërejtje”, e datës 24.01.2022 e shqiptuar ndaj ankuesit, është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, sepse nuk është shqiptuar në raport të drejtë me shkkeljen e kryer, rrjedhimisht udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, ka vepruar në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: “Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil”, e që në rastin konkret ankuesi edhe pse për mungesën në punë ka paraqitur shenjat mjekësore, të njëjtit i është shqiptuar kjo masë mbi bazën e mungesës së provave, e gjithë kjo edhe në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 1 dhe 2 , nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Agjencia Kosovare e Privatizimit konkretisht Njësia e Burimeve Njerëzore, është e obliguar që pas pranimit të vendimit të Këshillit, të ndërmarrë veprimet e duhura që nga dosja personale e ankuesit ta largoj vërejtjen me shkrim të datës 24.01.2022, e shqiptuar për ankuesin nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i tij, duke vepruar në pajtim me nenin 51 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe nenin 14 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.


Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenet 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.146/2022, datë 01/04/2022

Ardita Perçuku-Shyti


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

